

RELACION TEKNIK ARKITEKTONIK

Objekti : “Rikonstrukcion i shkollës Bularat, Dropull”

BASHKIA DROPULL

QARKU GJIROKASTER

1. Të dhëna të përgjithshme dhe gjëndja ekzistuese e objektit:

Vendodhja: Në fshatin Bularat, Bashkia Dropull.

Pershkrim: Shkolla e mesme e përgjithshme Bularat, ndodhet ne fshatin Bularat ,në rrethin e Gjirokastrës . Godina e shkollës është 2 katëshe dhe pjesërisht 3 katëshe . Mbulesa e godinës është me cati me tjegulla të kuqe dhe konstruksion druri.

Sipërfaqja e përgjithshme e territorit të godinës dhe fushave sportive është 3538 m². Ndërsa sipërfaqe e gjurmës së ndërtimit është 419 m².

Kapaciteti: Shkolla pwrbwhet nga 12 ambiente mësimore, ku 11 janë klasa dhe njëri është laborator i informatikës. Shkolla ka dhe ambjente të jashtme në të cilat zhvillohen aktivitete sportive dhe rekreative .



Figure 1 Ortofoto e zonës në studim



Figure 2 Foto egzistuese e zonës



Figure 3 Foto egzistuese e objektit

2. Problematika te objektit Egzistues:

- Vlerësimi fizik i objektit: Kushtet teknike dhe fizike në të cilat ndodhet godina e shkollës janë të pafavorshme për kryerjen normale të procesit mësimor, duke e bërë të domosdoshme ndërhyrjen për eliminimin dhe parandalimin e agravimit të strukturës.

Nga një vlerësim paraprak në objektin egzistues rezulton:

- Sistemi i ngrohjes realizohet me soba me dru në cdo klasë .
- Rrjeti elektrik përgjithësisht është i amortizuar dhe ambjentet janë të pajisura me ndricuesa me llampa elektrike.
- Pllakat e dyshemesë janë të amortizuara.
- Dyert e klasave janë të amortizuara, gjithashtu dhe dritaret kanë nevojë për ndërrim.
- Tualetet për nxënësit, janë në ambjentet e jashtme, ndërsa në ambjentet e brendshme ndodhen dy tualete të vogla jashtë kushteve standarte.
- Dyert janë të dëmtuara dhe nyjet hidrosanitare kanë probleme.
- Catia është me trarë druri dhe është në gjendje të amortizuar.
- Lagështira në mure është e pranishme pjesërisht në disa ambjente.
- Tavanet në katin e sipërm janë tavan plastik dhe në disa vende të dëmtuar.
- Nuk ka sistem të MNZ-së.
- Zilet elektrike janë jashtë funksionit.
- Terrenet sportive të jashtme janë në gjendje jo të mirë për të mundësuar praktikat e nxënësve.
- Hapësira për kopështin ndodhet në katin e podrumit ,gjë e cila nuk është e favorshme për fëmijët e kësaj kategorie.
- Ka mungesë të hapësirave për lojra për fëmijë.

-Shpërndarja e funksioneve në Katin Përdhe

Në Katin përdhe të objektit egzistues shpërndahen funksionet e tilla si ambjentet e klasave të mësimi për nxënësit, ku gjithsej numerohen dy të tilla, të orientuara në pjesën jugore të objektit. Gjithashtu janë të pozicionuara dhe biblioteka, salla e mësuesve dhe drejtoria. Në këtë kat ndodhet edhe dhoma e vatrës së kulturës dhe zyrës së këshillit të fshatit të cilat përdoren rrallë.

Në ambjentet e jashtme ndodhen tualetet për nxënësit dhe terrenet sportive të cilat zhvillohen në dyshe me prej betoni .




Figure 4 Planimetria Egzistuese e Katit Përdhe

-Shpërndarja e funksioneve ne Katin e Parë

Në Katin e Parë të objektit egzistues shpërndahen funksionet e tilla si ambjentet e klasave të mësimi për nxënësit, ku gjithsej numërohen nëntë të tilla, të orientuara në pjesën jugore të objektit, si dhe një ambjent për informatikë në pjesën perëndimore. Kryesisht kasat janë në hapësira të vogla për arsye se numri i nxënësve është tepër i vogël. Disa prej klasave kanë një numër minimal prej 4-5 nxënësish për shkak të numrit të popullsisë në këtë zone. Shihet një mungesë e tualeteve të cilat janë vetëm në territorin e jashtëm. Ambjentet e shkollës komunikojnë nëpërmjet një korridori 2 metra të gjerë.




Figure 5 Planimetria Egzistuese e Katit e pare

-Shpërndarja e funksioneve në Katin -1

Në Katin -1 të objektit egzistues shpërndahen funksionet e tilla si ambjentet e klasave të mësimit për nxënësit, si dhe një ambjent për kopshtin. Duke qënë se kjo është një hapësirë jo e favorshme për fëmijët e kësaj kategorie propozohet që ky ambjent të përdoret për ambjentin teknik të vendosjes së kaldajës dhe pajisjeve të tjera mekanike.




Figure 6 Planimetria Egzistuese e Katit e përdhe

3.Propozimi



Figure 7 Plani i Sistemit

-Shpërndarja e funksioneve në Sistemin e objektit

-Në sistemin e jashtëm të objektit është propozuar një fushë basketbolli me përmasa 24m x 13m me sipërfaqe 312 m², me shtresë akrilik, dhe e rrethuar me konstruksion metalik. Gjithashtu është parashikuar edhe një fushë dytësore 162 m², me shtresë akrilik me përmasa 18m x 9 m për volejbol.

Gjithashtu janë pozicionuar dhe ambjente stërvitje (paralele) të cilat do të jenë në sipërfaqe të mbuluar me material për absorbimin e goditjeve.

-Në pjesën e hyrjes në objekt është propozuar një hapësirë tip oborr e ngritur në një kuote pesë këmbë shkallë, e shtruar me beton të stampuar i cili imiton shtrimin me gurë. Kjo hapësirë do të shërbejë si ambjent grumbullimi për nxënësit , gjithashtu do të ketë gjelbërim dhe rrethim me kangjella metalike, si dhe stola për qëndrimin e tyre.

- Në këtë hapësirë është menduar një ndarje funksionale për hapësirën e lojrave të fëmijëve e cila do të ndahet nëpërmjet bordurës së gurit dhe gjelbërimit të tipit ligustër. Gjithashtu kjo hapësirë do të jetë e shtruar me material për absorbimin e goditjeve dhe do të ketë lojra për fëmijë të tipit lisharëse, lëkundëse, susta me figura animacionesh dhe rrëshkitëse. Për të aksesuar në të do të bëhet një ndërhyrje duke prishur një pjesë të murit ne anën perëndimore dhe krijimit të shkallëve për të aksesuar.

-Janë krijuar gjithashtu hapësira gjëlberimi,vendosja e stolave dhe koshave të mbeturinave.




Figure 8 Planimetria e Propozuar e Katit Përdhe

-Shpërndarja e funksioneve të reja në Katin Përdhe

Tualetet e brendshme egzistuese janë riorganizuar , duke i krijuar një hapsirë më të madhe, në të cilën është pozicionuar vetëm një tualet më të madh.

Gjithashtu dyert dhe dritaret e ambjenteve të klasave dhe të jashtme do të ndryshohen dhe do të vendosen të reja. Salla ekzistuese e mësuesve do të ndahet në dy klasa më të vogla për arsye të kërkesave sipas numrit të klasave për nxënësit. Ndërsa salla e mësuesve do të përshtatet në një ambient më të vogël pranë shkallëve.




Figure 9 Planimetria e Propozuar e Katit te Pare

-Shperndarja e funksioneve te reja ne Katin e Pare

-Në katin e parë funksionet e klasave dhe pozicionet e tyre nuk do të ndryshojnë, por ato do të rikonstrukturohen të gjitha. Do të lyhen muret, do të vendosen dyer dhe dritare të reja, pllaka të reja si dhe tavani i ri me kartonxhes.




Figure 10 Planimetria e Propozuar e Katit nentoke

-Shpërndarja e funksioneve të reja në Katin -1

Ambjenti teknik për vendosjen e pajiseve është propozuar të vendoset në katin ku më parë ishte kopshti i fëmijëve. Në të është propozuar edhe hapja e një dore teknike në anën e jashtme të fasadës, me dalje nga rruga në mënyrë që të ketë akses të lehtësueshëm .




Figure 11 Fasada kryesore Veri



Figure 12 Fasada kryesore Jug

-Fasada dhe prerje të objektit të propozuar

-Fasada e ndërtesës do të pastrohet nga papastërtitë e gurit dhe do të mbushen fugaturat në mënyrë që të forcohet materiali lidhës midis gurëve. Catia do të realizohet e re me tjegulla vendi në ngjyrë të kuqërremtë. Në fasadë janë propozuar strëhë me xham struktural në cdo hyrje ,dhe korniza dritarësh të cilat janë të dala nga muri i fasadës 30 cm në mënyrë që të krijohet një ritëm i tillë që do të thyejë uniformitetin e fasadës së gurit .Kangjellat do të vendosen të reja dhe pranë monumenteve do të krijohet nje sheshpushim në të cilin vizitorët mund të vizitojnë monumentet pa çënuar në territorin e shkollës.




Figure 13 Prerja 1-1

Muret do të suvatohen dhe do të lyhen me bojë hidromat cilësi e parë. Pjesa e poshtme do të ndahet me material druri $h=20$ cm dhe do të lyhet me bojë vaji në mënyrë që të jetë rezistente ndaj dëmtimeve që mund të shkaktohen gjatë lëvizjes së bankave apo karrigeve nga nxënësit.

-Ndërhyrjet e propozuara



Figure 14 Render i objektit te propozuar



Figure 15 Render i objektit te propozuar



Figure 16 Render i objektit te propozuar



Figure 17 Render i objektit te propozuar



Figure 18 Render i objektit te propozuar



Figure 19 Render i objektit te propozuar



Figure 20 Render i objektit te propozuar



Figure 21 Render i objektit te propozuar

Përgatiti :

Shoqëria **ZetaKonsult** sh.p.k
Administrator
Lorenc HOXHA